



**Hapet thirrja për mobilitet studenti të UPT-së,
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107
në Universitetin e Milanos, (Politecnico di Milano), Itali.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit të Milanos, publikohet thirrja për mobilitet për student të Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në Universitetin e Milanos.

- **Lloji i mobilitetit përfshin:** Shkëmbimin e studentëve për studime.
- **Kohëzgjatja e bursës:** Semestri i II i vitit akademik 2022 – 2023
- **Numri total i studentëve:** 1
- **Nivelet e mobilitetit për studentët:** Studenti duhet të jenë të regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe të ketë përfunduar një vit akademik.

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim student;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj* (Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.



**Key Action 1
– Mobility for learners and staff –**

**Ofrohen kurset në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Mobility Plan’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në POLIMI lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘Learning Agreement’ te seksioni ‘Commitment’ firmoset nga aplikanti, nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e ‘Learning Agreement’ klikoni më poshtë:

[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 15 nëntor 2022, ora 12.00.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al